



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

1
Nr.

18366/21
prot.

Tiranë, më

11.9
.2019

Lënda: Dërgohet Udhëzimi "Për një ndryshim në Udhëzimin plotësues nr.1, datë 17.01.2019
'Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019", të ndryshuar.


MINISTRIA/ INSTITUCIONI _____

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT _____

DEGA E THESARIT _____

Mbështetur në ligjin nr. 99/2018 "Për Buxhetin e vitit 2019" dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit", bashkëlidhur ju përcjellim Udhëzimin nr. 113, datë 11.9.2019 "Për një ndryshim në Udhëzimin plotësues nr.1, datë 17.01.2019, 'Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019", të ndryshuar.

MINISTËR


Anila Denaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

UDHËZIM PLOTËSUES

11.9.19

18366/20

Nr. $\frac{11}{3}$ datë 11.9.2019

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN PLOTËSUES NR. 1, DATË 17.01.2019 ‘PËR
ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2019’**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 22, të ligjit 99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019” dhe në vijim të Udhëzimit të ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2,

U D H Ë Z O J :

1. Në Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019”, “Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Pika 114, riformulohet si më poshtë:

“114. Njësitë shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore të kryejnë pagesën e pagave të punonjësve pas shkarkimit të deklaratës për detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shendetësore dhe të paraqesin njëkohësisht në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë urdhër shpenzimin për pagesën e pagave dhe urdhër shpenzimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shendetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat personale (në këtë proces të konsiderojnë kohën e nevojshme për celjen e numrave seriale të rinj në sistemin C@TS dhe ngarkimin e tyre në SIFQ nga D.P.Tatimeve).


2. Pika 115, riformulohet si më poshtë:

“115. Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë nuk autorizon pagesën e pagës nëse nuk është paraqitur njëkohësisht edhe pagesa për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shendetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat personale nga njësia shpenzuese e qeverisjes qendrore dhe vendore.

3. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë më 31 Dhjetor 2019.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANIJA DENAJ

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to read 'Anila Denaj', is written over the printed name.